

AKT-THEMELIM
I
SHOQËRISË

POSIDRIT sh.p.k.

Ne mbështetje të Ligjit Nr.9901,dt. 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”,
UNE, :

1-Florije Dervishi e bija e Adem-it i datelindjes 24-04-1964, lindur e banues ne Komoran e paisur me leternjofitim me Nr.1171892232.

Sot me dt. 10/07/2024, me vullnetin tim të lirë dhe të plotë, vendosa të hartojë këtë Akt-
Themelimi për krijimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar **POSIDRIT** sh.p.k. si

ORTAKET.

Akti i Themelimit hartohet me këto kushte:

Neni 1

Ortaku , me gjeneralitetet e mësipërme, me vullnet të lirë dhe të plotë krijoj Shoqërinë me
Përgjegjësi të Kufizuar **POSIDRIT** sh.p.k. .

Neni 2

Shoqëria vepron në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi që rregullon mënyrën e
organizimit dhe funksionimit të shoqërive tregtare dhe në përputhje me dispozitat e Statutit që i
bashkëlidhet këtij Akt – Themelimi.

Neni 3

Emri i plotë i shoqërisë është **POSIDRIT** sh.p.k. .

Neni 4

Selia e shoqërisë është në ,Kukes,Lagjja Nr.3,Rruga Mahmut Daci,Zona Kadastrale
Nr.2315,Nr.Pasurie 40/120. Sipas dispozitave të përcaktuara në Statut dhe në Akt –
Themelimit, veprimtaria e shoqërisë do të shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si
dhe jashtë saj, duke krijuar filialet apo degët e saj.

Neni 5

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar **POSIDRIT** sh.p.k. do të jetë ai i përcaktuar në Statutin e Shoqërisë :

Import-eksport te mallrave te ndryshem ushqimore dhe industriale.

Neni 6

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë **100.000 (njqind mije) leke** ndare ne **1** kuote . Kapitali themeltar mund të rritet sipas dëshirës së ortakut dhe kushteve në të cilat ushtron veprimtarinë, në formën dhe mënyrën e parashikuar në Statut.

Neni 7

Administrator i Shoqërisë do të jetë **Z.Fadil Dervishi** dhe kompetencat e tyre përcaktohen në Statut.

Neni 8

Viti financiar i Shoqërisë mbyllet me 31 Dhjetor, ora 24^{oo} te çdo viti kalendarik.
Bilanci vjetor i veprimtarisë së shoqërisë përfundohet brenda muajit Mars të vitit të pasardhës.

Neni 9

Shoqëria gëzon lirisht pronat dhe mjetet e saj financiare dhe ka të drejtë ti përdorë ato në përputhje me objektin dhe qëllimin e veprimtarisë së shoqërisë.

Neni 10

Ky Akt-Themelim do të jetë efektiv nga dita e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.
Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat të caktuar.

Për Shoqërinë

POSIDRIT shpk

ADMINISTRATORI

Fadil Dervishi

Ortaku

Floriije Dervishi

